



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:083347

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05802898

C.nr.648/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.K., avokat nga Avokatura Shtetërore, kundër të paditurit R.X., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, pasurim pa bazë, vlera e kontestit 97.50 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **04.06.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me seli në Prishtinë, **DETYROHET** i padituri R.X., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, që t’ia paguajë paditëses në emër të pasurimit pa bazë shumën prej 97.50 Euro, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, me padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri që t’ia paguajë paditëses në emër të pasurimit pa bazë shumën prej 97.50 Euro. Ka shtuar se i padituri ka filluar të marrë ndihmën sociale nga data 01.03.2019, e deri me datë 28.02.2020, mirëpo në muajin tetor të vitit 2019, i padituri është identifikuar si tatimpagues me të hyra financiare nga ATK, si i punësuar në “I... Sh.P.K”, dhe meqenëse nuk kishin arritur që të bëjnë marrëveshje për kthimin e pagesës, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kontestimore, është mbyllur në mungesë të të paditurit i cili është ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Aktvendimin nr.21862, i datës 11.03.2019; Aktvendimin nr.21862, i datës 04.11.2019; Ftesën nr.1117, e datës 04.11.2019, dhe Krahasimin e të dhënave SNS-ATK, për muajin tetor 2019.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi:

Nga Aktvendimi nr.21862, i datës 11.03.2019, vërtetohet fakti se, i padituri ka qenë përfitues i ndihmës sociale nga data 01.03.2019, e deri me datë 28.02.2020.

Nga Aktvendimi nr.21862, i datës 04.11.2019, vërtetohet fakti se, të paditurit i është ndërprerë ndihma sociale, pasi është konstatuar se Ai është punësuar.

Me anë të ftesës nr.1117, të datës 04.11.2019, vërtetohet fakti se, paditësja e ka ftuar të paditurin me qëllim të arritjes së marrëveshjes për kthimin e mjeteve të paguara në emër të ndihmës sociale për muajin tetor 2019.

Nga Krahasimi i të dhënave SNS-ATK, për muajin tetor 2019, vërtetohet se, i padituri është i punësuar tek I... Sh.P.K. dhe se detyrimi për kthimin e pagesës është në lartësi prej 97.50 Euro.

Me nenin 195 paragrafi 1 të LMD-së, përcakohet se: *“Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”*, ndërsa me paragrafin 3 përcaktohet se: *“Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”*.

Nga gjendja faktike e konstatuar e në lidhshmëri me të drejtën materiale të sipërcituar, gjykata ka vërtetuar se i padituri është përgjegjës për kthimin e mjeteve mbi bazën e pasurimit pa bazë, pasi nga provat e administruara u vërtetuar se i padituri ka qenë përfitues i ndihmës sociale nga data 01.03.2019, deri më datë 28.02.2020.

Në vendimin me të cilin është aprovuar ndihma sociale thuhej shprehimisht se, familja obligohet që për çdo ndryshim të rrethanave socio-ekonomike të njoftojë QPS-së. I padituri në ndërkohë është punësuar në tetor 2019, por nuk e kishte njoftuar paditësen, respektivisht QPS-në, për ndryshimin e statusit të tij të punësimit.

Rrjedhimisht, i padituri vazhdoi të merrte asistencë sociale edhe për muajin tetor 2019, pavarësisht se ishte i punësuar, pasi punësimi i tij e zhvlerësoi bazën e tij për marrjen e një ndihme të tillë sociale.

Dështimi i të paditurit për të njoftuar paditësen, respektivisht QPS-në, për ndryshimin e statusit të tij të punësimit përbënte shkelje të detyrimeve të tij si përfitues i ndihmës sociale, ku ky dështim çoi në vazhdimin e pagesave të cilat duhet të ishin ndërprerë, pasi baza e ndihmës (papunësia e paditësit) nuk ekzistonte më, në përputhje me nenin 194, paragrafi 3 të LMD-së, ku përcaktohet se: *“Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”*.

E paditura përmes organeve kishte vepruar brenda të drejtave të saj për të rikuperuar fondet e marra në mënyrë të parregullt duke e ftuar të paditurin të bëjë një marrëveshje për kthimin e shumës prej 97.50 Euro, procedurë kjo, standarde për të korrigjuar situatën kur një përfitues i ndihmës sociale nuk përmbush detyrën e tij për të informuar autoritetet përkatëse për ndryshimet që ndikojnë në statusin e tij të punësimit, dhe meqenëse i padituri nuk i ishte përgjigjur ftesës për arritjen e marrëveshjes, duke marrë kështu ndihmën sociale edhe për muajin tetor 2019, atëherë i padituri është pasuruar pa bazë, me ç’rast edhe kërkesëpadia e paditëses në kuptim të nenit 194 paragrafi 1 të LMD-së, rezultoi si e bazuar.

Gjykata ka vendosur që konform nenit 420 paragrafi 3 të LPK-së, shqyrtimin kryesor t’u mbajë menjëherë pas seancës përgatitore, sepse nga paditësja në seancën përgatitore nuk janë paraqitur pretendime të reja faktike apo argumente juridike, nga ato të paraqitura në padi, dhe duke mos pasur nevojë për marrjen e provave, gjykata vendosi që shqyrtimin kryesor ta mbyll në mungesë të të paditurit, të ftuar në mënyrë të rregullt.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.648/19, të datës 04.06.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.